

HIDRO IZOLUESIT



HIDROFIX FOUNDATION

	Ngjyra	Paketimi	Konsumi
A	Gri	Thes 22 KG	1.65 (kg/m ²)/mm trashësia
B	E bardhë	Bidon 10 KG	

PËRSHKRIM

Hidroizolues bikomponent me fleksibilitet të lartë me bazë çimento, me inerte të seleksionuar dhe aditivë speciale. Për hidroizolim të strukturave të betonit ose mureve që i nënshtrohen presioneve hidrostatoke pozitive ose negative. I përshtatshëm për muret e themelit, parkingje, bodrume, vaska, pishina dhe kanale. Për ambiente të jashtme dhe të brëndshme. I papërshkueshem nga uji. Rezistent ndaj kripërave të detit, klorureve, sulfateve etj.

FUSHA E APLIKIMIT

Mbrojtje fleksibël dhe hidroizoluese për banjo, dushe, ballkone, bodrume, taraca, vaska dhe parkingje. Mbrojtës i sipërfaqeve të betonit. Duke përzjerë dy komponentët fitohet një përzjereje me veti të lartë elastike dhe i jep produktit veti shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve, pas rregullimit paraprak të suportit (nivelimit).

PËRGATITJA E SUPORTIT


Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra, jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhet të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Hidhni komponentin B të lëngshëm (10KG) në një enë të pastër dhe duke e përzier hidhni komponentin A të thatë (22KG). Përzieni me një përzierës mekanik derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa fluska ajri për rreth 2 min. Lëreni në qetësi për 4 minuta dhe përzieni produktin përsëri përpara aplikimit.

APLIKIMI





Aplikoni produktin në dy shtresa me furçë, rul ose shpatull, duke e aplikuar rreth 2mm për çdo dorë. Dora e dytë aplikohet pas një periudhë prej 4-6 orë nga njëra-tjetra dhe jo para tharjes së dorës së parë. Produkti përdoret vetëm duke kombinuar komponentin A me komponentin B dhe në sasinë e rekomanduar. Aplikoni produktin në temperaturë nga +5°C deri +35°C. Për presione pozitive (Presioni i ujit direkt mbi veshje dekorative) Sipërfaqja e aplikimit duhet të jetë e qëndrueshme dhe e pastër. Hiqni rrjedhjet e betonit, pjesët që thërrmohen, pluhurin dhe vajrat e armaturës, nëse është e nevojshme me ujë nën presion. Për hidroizolime në rast bazamentesh të vjetra bëni riparimin e bazamentit me produktet deKoll të posaçme.



Përpara aplikimit të Hidrofix Foundation për të përmirësuar ngjitjen me bazamentin është e nevojshme lyerja me prajmerin akrilik në dispersion ujor. Prajmeri hollohet në raportin 1:1 me ujë, l aplikueshëm me furçë ose rrul. Për presione negative (Presioni i ujit mbi veshje i depërtuar nga bazamenti) Sipërfaqja e aplikimit duhet të jetë e qëndrueshme dhe e pastër. Hiqni rrjedhjet e betonit, pjesët që thërrmohen, pluhurin dhe vajrat e armaturës, nëse është e nevojshme me ujë nën presion. Bëni stukimin e bazamentit me produktet e posaçme dekolli.

TË DHËNAT TEKNIKE

Komponenti A	
Pamja: Pluhur	Trashësia për shtresë: 1-2 mm (për dorë)
Paketimi: Thes letre 22 kg ne paleta 1188 kg.	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Ngjyra: Gri	Granulometria: 0.7mm
Konsumi: 1.65 kg/mm trashësi	Ngjitja në beton (28 ditë): $\geq 1\text{N/mm}^2$
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Forca ngjitëse pas imersionit në nxehtësi: $\geq 1\text{N/mm}^2$
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Përkueshmëria: I papërkueshëm
pH i përzierjes: >12	Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1
Masa vëllimore: 1.6-1.7 gr/cm ³	
Komponenti B	
Pamja: Lëng	Magazinimi: 24 muaj
Paketimi: Bidon 10 Kg	Masa Vëllimore: 1.2 gr/cm ³
Ngjyra: E bardhë	



Kujdes! Mos përdorni produktin në shtresa me trashësi të mëdha (trashësia e lejuar 2 mm për dorë). Mos aplikoni produktin në temperatura nën +5°C. Mos përdorni produktin në bazamente të lagura. Mos përzieni produktin me lëndë të tjera. Mbrojeni produktin nga shiu ose nga ujra të forta në 24 orët e para të aplikimit.